

V E N D I M
Nr. 278, datë 10.6.1999

**PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE TË KUSHTEVE TË BONOVE TË THESARIT PËR
DETYRIMET E SHTETIT NDAJ BANKËS KOMBËTARE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr. 8469, datë 31.3.1999 «Për një ndryshim në ligjin nr. 8169, datë 21.12.1996 «Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1648, datë 20.11.1996 «Për thellimin e mëtejshëm të procesit të privatizimit të bankave tregtare, me kapital tërësisht shtetëror», me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Bonot e thesarit, që do të lëshohen për konvertimin e detyrimeve të shtetit ndaj Bankës Kombëtare Tregtare, sipas ligjit nr. 8469, datë 31.3.1999, të jenë sipas termave, kushteve dhe karakteristikave të mëposhtëme:

- a) Emetuesi Ministria e Financave
 - b) Lloji i letrave me vlerë Bono thesari
 - c) Forma e emetimit: Me vlerë të skontuar në formë regjistrimi në Bankën e Shqipërisë
 - ç) Data e emetimit 1.1.1999
 - d) Shuma e emetimit 4.291 milionë lekë
 - dh) Struktura e emetimit: Prerje 1 milion lekëshe, me numër rendor nga 1 në 4.291
 - e) Afati i maturimit: 6 muaj, me të drejtë rinovimi në maturim.
 - ë) Norma e interesit: E barabartë me nivelin mesatar të Yield-it në dy ankandet e fundit të bonove të thesarit, me afat maturimi 6-mujor.
 - f) Tregtueshmëria Bonot mund të shiten apo të skontohen nga mbajtësi, sipas zhvillimeve të situatës monetare dhe pozicioneve të likuiditetit të sistemit bankar, në përgjithësi, dhe të bankave, në veçanti.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko